

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6131
E hënë, 5 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi pranon letër falënderimi nga Shtëpia e Bardhë për dekorimin e Trumpit | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FAIK NIKA | FAQE 4-5

Mali i Zi s' do të ketë ndryshime thelbësore ndaj Kosovës

Kryetari i Këshillit Kombëtar i Shqiptarëve në Mal të Zi, Faik Nika, nuk pret ndryshime thelbësore të Malit të Zi ndaj Kosovës nga qeveria e re, e cila pritet të formohet së shpejti. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se përfaqësuesit e subjekteve politike që do ta bëjnë shumicën e re kanë pranuar se orientimet strategjike në politikën e jashtme të Malit të Zi nuk do të ndryshojnë. Nika ka thënë se shqiptarët e Malit të Zi nuk kanë ndonjë pritje të madhe nga kjo qeveri. Ai ka bërë me dije se zhvillimi ekonomik dhe asimilimi i shqiptarëve janë sfidat kryesore me të cilat përballen



FAQE 4-5

AKTUALE

TRUMPI THOTË SE NDIHET SHUMË MË MIRË: DO TA MUNDIM KORONAVIRUSIN | F. 2

RAMA, VULINIT: UÇK-ja KA QENË ÇLIRIMTARE, VRASËSIT JANË NË BEOGRAD | F. 8

PKD-ja KRITIKON LDK-në DHE LV-NË PËR QEVERISJEN NË PRISHTINË | F. 8

EKONOMI

LINJA HEKURUDHORE DURRËS - PRISHTINË, PROJEKT I DOMOSDOSHËM | F. 8

PRONARI I KOMPANISË "MEKA": PRODHIMET TONA JANË MË CILËSORE SE ATO TË IMPORTUARA | F. 8



KULTURË

NË ST. GALLEN U PREZANTUA LIBRI "BLEIBENDE SPUREN" | F. 13



SPORT

KOSOVA BËHET PJESË E 160 VENDEVE TË BOTËS PËR SHËNIMIN E DITËS BOTËRORE TË ECJES | F. 15

KOSOVA NË AGJENDËN E KËSHILLIT TË SIGURIMIT MË 21 TETOR



Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do ta mbajë takimin informues të radhës për Kosovën më 21 tetor. Nuk dihet aktualisht në çfarë forme do të mbahet takimi për Kosovën. Në muajin prill takimi u zhvillua virtualisht | FAQE 3

HAPET SEZONI TURISTIK VJESHTË-DIMËR, INSTITUCIONET PREMTOJNË MBËSHETJE PËR TURIZMIN | FAQE 9



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi thotë se ndihet shumë më mirë: Do ta mundim koronavirusin



UASHINGTON, 4 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i cili po trajtohet për sëmundjen Covid-19 në një spital ushtarak pranë Uashingtonit, ka pohuar se ndihet shumë më mirë dhe se shpreson se do të kthehet së shpejti në punë, për ta përfunduar fushatën përpara zgjedhjeve presidenciale të 3 nëntorit.

Në një video katërminutëshe të postuar në llogarinë e vet në "Twitter", Trumpi ka thënë se ditët e ardhshme do të jenë "prova e vërtetë", ndërsa i ka falënderuar të gjithë në Shtetet e Bashkuara dhe në të gjithë

botën për mbështetjen e tyre. "Ne do ta mundim këtë koronavirus", ka deklaruar Trump, duke shprehur optimizëm për efektivitetin e terapive kundër koronavirusit. Trumpi dhe Zonja e Parë, Melania, u diagnostikuan me Covid-19 të premten.

Presidenti Trump në të njëjtën ditë u shtrua në Qendrën Mjekësore Ushtarake Walter Reed. Mjekët që janë duke e trajtuar presidentin, thanë më herët se ai është në "disponim jashtëzakonisht të mirë", pa temperaturë dhe pa vështirësi në frymëmarrje, ndërsa një anëtar i stafit të tij tha se dy ditët

e ardhshme do të jenë kritike për presidentin 74-vjeçar. "Këtë mëngjes presidenti ndihet shumë mirë", ka deklaruar doktor Sean Conley. Trumpi ka qenë pa temperaturë për 24 orë dhe aktualisht nuk po trajtohet me oksigjen, shtoi ai. "Ekipi dhe unë jemi jashtëzakonisht të lumtur me përparimin që ka bërë presidenti", ka pohuar Conley, por nuk pranoi të thotë se kur pritet të lirohet nga spitali.

Mjekët, po ashtu, refuzuan të thonë nëse presidenti ka kërkuar ndonjëherë oksigjen, pavarësisht prej pyetjeve të përsëritura nga gazetarët.

Franca dhe Italia goditen nga një stuhi e fuqishme

NICË, 4 TETOR - Të paktën dy njerëz kanë vdekur dhe 20 janë ende të zhdukur pasi një stuhi e fuqishme goditi Francën juglindore dhe Italinë veriperëndimore.

Stuhia Aleks solli erëra të ashpra dhe shi të rrëmbyeshëm. Një numër fshatrash në veri të Nicës në Francë pësuan dëme serioze nga përmblytjet dhe rrëshqitjet e tokës, me rrugë, ura dhe shtëpi të shkatërruara.

Në veriperëndim të Italisë, përmblytja u përshkrua si "historike". Një pjesë e një ure mbi lumin Sesia u shemb. Kryeministri francez Jean Castex

ka vendosur ushtrinë dhe ka miratuar fonde emergjente për t'i trajtuar përmblytjet më të këqija për dekada në Francën jug-lindore. Rreth 20 persona janë zhdukur ose nuk janë regjistruar me të afërmit. "Ka shumë njerëz për të cilët nuk kemi asnjë lajm", ka thënë Castex.

Agjencia Meteorologjike Meteo-France tha se 450 mm (17,7 in) shi ra në disa zona gjatë 24 orëve, ekuivalent i gati katër muajve në këtë kohë të vitit, raporton agjencia e lajmeve "Reuters". Në rajonin jugor të alpeve u shkaktua dëmi më i madh.



Egjipti zbulon arkivole antike 2 500 vjet të vjetra



KAJRO, 4 TETOR - Egjipti zbuloi 59 arkivole antike që u përkisnin priftërinjve dhe nëpunësve në një nekropol të gjerë në jug të Kajros. Një mision arkeologjik egjiptian më 3 tetor shfaqti sarkofagët, me mumiet brenda shumicës së tyre, duke thënë se ata ishin varrosur më shumë se 2 500 vjet më parë.

Ekipi zbuloi mbetje të mumifikuara të mbështjella me pëlhura të varrimit që mbanin mbishkrime hieroglifike me ngjyra të

ndritshme.

Arkivole prej druri të ruajtura dhe të vulosura mirë, si dhe 28 statuja të Zotit Sekret Egjiptian të lashtë, u zbuluan javët e fundit, të varrosura në tre boshte në Sakara, nekropoli i kryeqytetit të lashtë egjiptian Memfis, pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. "Unë e konsideroj këtë si fillim i një zbulimi të madh", ka thënë ministri i Egjiptit për Turizmin dhe Antikitete Khalid el-Anany, duke shtuar se më

shumë zbulime ende pritet të dalin në të njëjtën zonë.

Mostafa Waziri, sekretar i përgjithshëm i Këshillit Suprem të Antikiteteve, tha se studimet fillestare tregojnë se arkivole e zbuluara ishin bërë për priftërinjtë dhe zyrtarin e lartë nga Periudha e Vonë Faraonike rreth vitit 664-525 B.C.

Arkivole dhe gjetjet e tjera do të ekspozohen në muzeun e ri egjiptian, të cilin Egjipti po e ndërton pranë Piramidave të Gizës.

India synon të sigurojë 500 milionë doza të vaksinës për koronavirus

NEW DELHI, 4 TETOR - India shpreson të marrë deri në 500 milionë doza të vaksinës kundër koronavirusit deri në korrik të vitit të

ardhshëm për rreth 250 milionë njerëz. Kështu ka thënë të dielën ministri i Shëndetësisë, Harsh Vardhan, derisa infeksionet në

vendin e dytë më të prekur në botë vazhdojnë të rriten. India ka regjistruar rreth 6.55 milionë raste, 75 829 në 24 orët e fundit,

ndërsa vdekjet e lidhura me Covid-19 kanë arritur gjithsej në 101 782, sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë.



Kosova në agjendën e Këshillit të Sigurimit më 21 tetor

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do ta mbajë takimin informues të radhës për Kosovën më 21 tetor. Nuk dihet aktualisht në çfarë forme do të mbahet takimi për Kosovën. Në muajin prill takimi u zhvillua virtualisht

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 TETOR - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do ta mbajë takimin informues të radhës për Kosovën më 21 tetor. Është ky takimi i dytë për këtë vit, pas atij të mbajtur më 24 prill. Rusia drejton aktualisht presidencën mujore të Këshillit të Sigurimit. Ambasadori rus pranë OKB-së, Vassily Nebenzia, ka shpjeguar se më 8 tetor Këshilli i Sigurimit do të mbledhet fizikisht në sallën e vet, shtatë muaj pas mbajtjes së takimeve në rrugë virtuale për shkak të Covid-19. Nuk dihet aktualisht në çfarë forme do të mbahet takimi për Kosovën. Në muajin prill takimi u zhvillua virtualisht. Sipas njoftimeve paraprake të securitycouncilreport.org i Dërguari Special dhe shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin, do ta

informojë Këshillin e Sigurimit për zhvillimet e fundit në Kosovë.

Deri më 9 tetor anëtarët e Këshillit të Sigurimit do ta marrin në dorë raportin për Kosovën të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres. Mbi bazën e tij, anëtarët e Këshillit të Sigurimit përgatisin fjalën që do të mbajnë në takim.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq nënshkruan më 4 shtator marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike. Nënshkrimi u bë në Shtëpinë e Bardhë në prani të presidentit amerikan Donald Trump, mbasi delegacionet zhvilluan dy ditë bisedime në prani të administratës amerikane. Marrëveshja fokusohet kryesisht në përmirësimin e marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve



dhe rikonfirmon disa nga marrëveshjet e vendosura më parë, si ajo për vendosjen e transportit hekurudhor dhe ndërtimin e një autostrade midis Prishtinës dhe Beogradit. Po ashtu, është rënë dakord për ta shtyrë për një vit kërkimin nga Kosova të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare dhe fushatën serbe për t'i bindur vendet që e kanë njohur Kosovën, që t'i kthejnë mbrapsht njohjet.

Më tej marrëveshjet përmbajnë përmirësimin e marrëdhënieve me Izraelin: Kosova dhe Izraeli ta njohin njëri-tjetrin dhe Serbia ta vendosë ambasadën e vet në Jerusalem. Si Kosova ashtu dhe Serbia kanë rënë dakord që t'i quajnë Hezbollahët organizatë terroriste. Kur folën për mediat, si Vuçiqi ashtu edhe Hoti dhanë interpretime të ndryshme për marrëveshjet. Vuçiqi tha se Serbia nuk ka nënshkruar marrëveshje trilaterale, por

vetëm marrëveshje bilaterale me ShBA-në që nuk përfshin njohjen e një pale të tretë, duke bërë aludime për Kosovën. Kurse Hoti e quajti marrëveshjen hap përpara për të arritur te marrëveshja finale dhe njohja reciproke. Bisedimet e nivelit të lartë midis Beogradit dhe Prishtinës, të drejtuara nga Bashkimi Evropian, u mbajtën në muajin korrik, pas një pushimi 20 muajsh.

Rama, Vulinit: UÇK-ja ka qenë çlirimtare, vrasësit janë në Beograd



TIRANË, 4 TETOR (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i është përgjigjur ministrit serb të Mbrojtjes, Aleksandër Vulin, pas deklaratave raciste në një komunikatë zyrtare të ministrisë që drejton. Rama është shprehur se ka një të vërtetë të thjeshtë që nuk do të mund të ndryshohet, ajo që ushtria serbe ka pushtuar Kosovën dhe jo e kundërta. Kryeministri Rama i ka thënë

Vulinit se kriminelët janë në Beograd. "Sa i përket UÇK-së, ata janë çlirimtarë dhe jo vrasës. Vrasësit janë në Beograd. Ata nuk e ndryshojnë dot një fakt të thjeshtë: nuk sulmoi Kosova Serbinë. Nuk ishin tanket e Kosovës që hapën rrugën e një ushtrie për të bërë spastrim etnik. Ishin ushtarët e Sllobodan Millosheviqit. Një ushtri e rregullt e përdorur për përdhunime dhe spastrim

etnik. Çlirimtarët janë në Kosovë, kriminelët e asaj lufte janë nën dhe disa dhe mbi dhe disa të tjerë në Beograd", ka deklaruar Rama. Më tutje, Rama ka thënë se është neveritur kur e ka kuptuar se deklaratat e Vulinit ishin të vërteta. "Jam neveritur dhe kur kam kuptuar që deklarata e këtij zotërisë nuk ishte meme. Se s'ka mundësi që deklarata e një anëtari qeverie në vitin 2020 të jetë një

gojë kaq e shturur dhe një mendje kaq e errët. Pastaj, kuptova që nuk ishte meme. Ka edhe një të mirë që ekstremistët shqiptarë në Prishtinë më akuzojnë se po punoj për Jugosllavinë e Madhe, ndërsa ata në Serbi po punoj për Shqipërinë e Madhe. Presidenti i Serbisë duhet të japë sqarime për këtë çështje. Unë kam qenë shumë i qartë. Shengeni rajonal është vendosja e 4 kushteve të

Bashkimit Evropian. Kushti i parë është liria e Brukselit, ku njerëzit të lëvizin pa ndalesa në kufi. Ne duam ta heqim kufirin edhe me Serbinë. Kjo nuk u pëlqen ekstremistëve shqiptarë. Ata synojnë ta mbajnë peng të sotmen me kthetrat e të shkuarës", ka thënë Rama. Vulini në një komunikatë zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes së Serbisë ka përdorur gjuhë denigruese kundrejt shqiptarëve.



Flet për “Epokën e re”, Faik Nika

MALI I ZI S'DO TË KETË NDRYSHIME THELBËSORE NDAJ KOSOVËS

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, Faik Nika, nuk pret ndryshime thelbësore të Malit të Zi ndaj Kosovës nga qeveria e re, e cila pritet të formohet së shpejti. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se përfaqësuesit e subjekteve politike që do ta bëjnë shumicën e re kanë pranuar se orientimet strategjike në politikën e jashtme të Malit të Zi nuk do të ndryshojnë. Nika ka thënë se shqiptarët e Malit të Zi nuk kanë ndonjë pritje të madhe nga kjo qeveri. Ai ka bërë me dije se zhvillimi ekonomik dhe asimilimi i shqiptarëve janë sfidat kryesore me të cilat përballen

nuk do të ketë ndryshime nga kursi i deritashëm. Le të shpresojmë se mund të bëhet diçka më mirë në aspektin e zhvillimit ekonomik, luftën kundër korrupsionit dhe shtetin e së drejtës”, ka thënë Nika.

Ai shpreson se tri subjektet politike do t'i përmbahen kësaj marrëveshje. “Besojmë se në politikën e jashtme të Malit të Zi, në veçanti ndaj Kosovës nuk do të ketë ndryshime thelbësore, përderisa kjo nuk varet vetëm nga njëri subjekt apo koalicion, pjesëtarë të qeverisë së ardhshme. Ne shpresojmë se do të respektohen parimet kryesore të marrëveshjes paraprake të partnerëve të koalicionit ku, ndër të tjera, pikë e veçantë është edhe respektimi i njohjes dhe pavarësisë së Kosovës. Shpresojmë se do t'u përmbahen zotimeve të nënshkruara dhe të deklaruar publikisht”, është shprehur ai. Nika ka thënë se shqiptarët e Malit të Zi nuk kanë ndonjë pritje të madhe nga kjo qeveri. “Në përgjithësi, nuk mund të

themi se kemi pritshmëri të mëdha duke i ditur qëndrimet dhe deklaratat e partnerëve të tjerë të këtij koalicioni lidhur me orientimet strategjike të Malit të Zi, shtetësinë e Malit të Zi, pranimin e Kosovës si shtet i pavarur në integrimet euro-atlantike etj”, ka deklaruar ai. Më tej, Nika ka theksuar se shqiptarët e këtyre trevave duan të drejta të barabarta si të minoriteteve të tjera. “Ne si popull autokton në Mal të Zi kërkojmë që të kemi të drejta të barabarta si të gjithë pjesëtarët e etnive të tjera që bëjnë pjesë në këtë shtet, edhe pse kemi veçori të theksuara kulturore, gjuhësore e gjeografike në krahasim me popujt e tjerë që në përgjithësi janë sllavofonë”, ka thënë ai. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për sfidat me të cilat përballen shqiptarët e kësaj pjese.

“Epoka e re”: Qeveria malazeze ka dhënë pëlqimin rreth përdorimit të flamujve, himneve dhe ditëve të festave kombëtare të komuniteteve.

Cila është rëndësia e kësaj për shqiptarët?

Nika: Shqiptarët në Mal të Zi kanë pasur probleme të vazhdueshme në lidhje me përdorimin e simboleve kombëtare duke qenë se simbolet kombëtare janë konsideruar simbolet e një shteti tjetër. Ne si Këshill Kombëtar i kemi sqaruar Qeverisë së Malit të Zi disa herë rreth flamurit tonë kombëtar, lashtësisë së tij dhe arsyes përse pikërisht flamuri kuqezi përfaqëson çdo shqiptar kudo që ndodhet. Në disa raste shqiptarët janë përballur me gjoba të ndryshme për shkak të shpalesjes së flamurit kombëtar. Me ligjin aktual për simbolet kombëtare dhe dhënien e këtij pëlqimi nga ana e Qeverisë së Malit të Zi, besojmë se një herë e mirë u jepet fund paqartësive lidhur me përdorimin e lirë të simboleve kombëtare nga shqiptarët në Malin e Zi dhe pranohet flamuri kombëtar i njëjti siç është flamuri kombëtar i cili përdoret nga të gjithë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINE, 4 TETOR - Kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, Faik Nika, nuk beson se qeveria e re e Malit të Zi, e cila pritet të formohet, do t'i ndryshojë orientimet strategjike në politikën e jashtme. Ai ka bërë me dije se partnerët e koalicionit të ri janë zotuar se qeveria e re nuk do të ketë ndryshime thelbësore ndaj Republikës së Kosovës.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Nika ka thënë se ndër parimet kryesore të marrëveshjes mes partnerëve të koalicionit që do ta bëjnë shumicën është edhe respektimi i njohjes së Republikës së Kosovës. “Në një marrëveshje paraprake të nënshkruar nga përfaqësues të tre koalicioneve që do ta bëjnë shumicën e re dhe ta formojnë qeverinë kanë pranuar se në orientimet strategjike në politikën e jashtme të Malit të Zi



Zi janë më të pazhvilluarat nëse i krahasojmë me qytetet dhe qendrat e tjera në Mal të Zi. Të ardhurat e pakta dhe mungesa e vendeve të punës për të rinjtë sjellin edhe sfidën tjetër që është migrimi i shqiptarëve dhe kështu kjo sjellë zvogëlimin e numrit të shqiptarëve që janë banues të përhershëm në Mal të Zi dhe kjo përqindje, që dita-ditës është në rënie, po ashtu probleme të tjera që lidhen zinxhir dhe bëjnë faktorin politik shqiptar akoma më të dobët. Në anën tjetër kemi problem të theksuar fenomenin e asimilimit të shqiptarëve në Malin e Zi dhe deklarin e tyre si pjesëtarë të kombësive të tjera. Sfida të tjera janë përherë edhe ruajtja e identitetit tonë kombëtar, ruajtja e gjuhës shqipe, arsimit shqip në Mal të Zi etj.

“Epoka e re”: Mali i Zi është në prag të ndërrimit të pushteteve. Njëra prej subjekteve që synon të bëhet pjesë e qeverisë udhëhiqet nga një shqiptar. Cilat janë pritjet e juaja nëse kjo parti do të bëhet pjesë e qeverisë së re?

Nika: Në përgjithësi nuk mund të themi se kemi pritshmëri të mëdha duke i ditur qëndrimet dhe deklaratat e partnerëve të tjerë të këtij koalicioni lidhur me orientimet strategjike të Mali të Zi, shtetësinë e Malit të Zi, pranimin e Kosovës si shtet i pavarur në integrimet euro-atlantike etj. Por në një marrëveshje paraprake të nënshkruar nga përfaqësues të tre koalicioneve që do të bëjnë shumicën e re dhe formojnë qeverinë kanë pranuar se në orientimet strategjike në politiken e jashtme të Malit të Zi nuk do të ketë ndryshime nga kursi i deritashëm. Le të shpresojmë se mund të bëhet diçka për më mirë në aspektin e zhvillimit ekonomik, luftën kundër korrupsionit dhe shtetin e së drejtës.

“Epoka e re”: Siç dihet, partia kryesore e koalicionit që synon ta formojë qeverinë e re është pro serbe dhe dihet qëndrimi i saj ndaj shtetit të Kosovës. Mund të ndërrojë politika e jashtme e Malit të Zi ndaj Kosovës me qeverinë e re?

Nika: Siç e potencova edhe më lart, besojmë se në politikën e jashtme të Malit të Zi, në veçanti ndaj Kosovës, nuk do të ketë ndryshime thelbësore përderisa kjo nuk varet vetëm nga njëri subjekt apo koalicion, pjesëtarë të qeverisë së ardhshme. Ne shpresojmë se do të respektohen parimet kryesore të marrëveshjes paraprake të partnerëve të koalicionit ku, ndër të tjera, pikë e veçantë është edhe respektimi i njohjes dhe pavarësisë së Kosovës. Shpresojmë se do t'u përmbahen zotimeve të nënshkruara dhe të deklaruara publikisht.

Thaçi pranon letër falënderimi nga Shtëpia e Bardhë për dekorimin e Trumpit

PRISHTINË, 4 TETOR - Shtëpia e Bardhë e ka falënderuar Hashim Thaçin, presidentin e vendit, për dekorimin e Donald Trumpit, presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), me Medaljen e Urdhrit të Lirisë si mirënjohje për kontributin e tij të dhënë ndaj popullit të Kosovës.

Ishte këshilltari për Siguri Kombëtare i Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Robert O'Brien, e bëri këtë falënderim në emër të Shtëpisë së Bardhë me anë të

një letre dërguar Thaçit. Aty thuhet se Trumpi beson fuqishëm se do të ketë normalizimin të qëndrueshëm në Ballkan pas nënshkrimit të marrëveshjes ekonomike në Uashington më 4 shtator në mes të Serbisë dhe Kosovës. “Presidenti Trump është përkrahës i vendosur i Kosovës dhe beson fuqishëm se masat historike për normalizim ekonomik të arritura në Shtëpinë e Bardhë më 4 shtator 2020 do ta ndihmojnë paqen dhe stabilitetin e qëndrueshëm

në Ballkan”.

Në letër theksohet se e vlerësojnë mbështetjen e Kosovës për normalizimin ekonomik me Serbinë. “Është nder i madh të qëndrosh me popullin e Kosovës dhe ne e vlerësojmë mbështetjen tuaj të fortë për zbatimin e normalizimit ekonomik me Serbinë”, theksohet në letër.

O'Brien, Thaçin e falënderon edhe për Medaljen Presidenciale të Meritave të Kosovës që ia ka ndarë atij dhe Richard Grenellit, emisarit të ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi.



shqiptarët në mbarë botën.

“Epoka e re”: Sa jeni të kënaqur me respektimin e të drejtave të shqiptarëve në këtë shtet?

Nika: Ne si popull autokton në Mal të Zi kërkojmë që të kemi të drejta të barabarta si të gjithë pjesëtarët e etnive të tjera që bëjnë pjesë në këtë shtet, edhe pse kemi veçori të theksuara kulturore, gjuhësore e gjeografike në krahasim me popujt e tjerë që në përgjithësi janë sllavofonë. Megjithatë ne duam të trajtohem të barabartë në përfaqësim institucional, në përfitim të mirave materiale që shkojnë në buxhetin e shtetit nga shfrytëzimi i resurseve të vendbanimeve të shqiptarëve në Malin e Zi, që nënkupton shpërndarje të drejtë të pasurisë dhe investimeve publike kapitale. Po t'i lexojmë ligjet në Mal të Zi kuptojmë se janë në nivel dhe shqiptarët kanë të drejtat e garantuara qoftë me Kushtetutë, qoftë sipas konventave ndërkombëtare, megjithatë nuk mund të themi të njëjtën gjë për anën praktike, që do të thotë ka ngecje në zbatueshmërinë e ligjeve.

“Epoka e re”: Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen shqiptarët atje?

Nika: Për shqiptarët në Mal të Zi mund të themi se sfidë kryesore tani kemi aspektin e zhvillimit ekonomik, duke qenë se zonat e banuara me shqiptarë në Mal të

Pandemia rrit nivelin e kredive të këqija

PRISHTINË, 4 TETOR - Në bankat komerciale në Kosovë është rritur niveli i kredive joperformuese për arsye se biznese të shumta private, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi i ri, nuk kanë arritur t'i kthejnë kështu e kredisë brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Kur klientët nuk arrijnë t'i kthejnë me kohë kështu e kredive, atëherë ato bëhen problematike dhe nëse ky problem nuk zgjidhet brenda afatit prej 90 ditësh, atëherë kreditë konsiderohen joperformuese apo, siç njihen ndryshe, kredi të këqija. Sipas të dhënave zyrtare, përqindja e kredive joperformuese në muajin gusht të këtij viti ka arritur në 2.6 për qind nga 1.9 për qind sa ishte në fund të vitit të kaluar.

Kompanitë prodhuese të materialit ndërtimor dhe ato ndërtuese thonë se muajit e fundit ka rënie të interesimit për blerjen e banesave, çka ka vështirësuar gjendjen e tyre financiare, rrjedhimisht edhe kthimin e kësteve të kredive.

Se ka pasur zvogëlim të investimeve në sektorin e ndërtimit deri në 12 për qind, thuhet edhe në raportin e fundit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Kurse në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) thuhet se në tremujorin e dytë të këtij viti ka pasur rënie të Bruto Produktit Vendor prej 9.8 përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Aktivitetet ekonomike që kanë shënuar rënie më të madhe janë nga sektori i ndërtimit me 47 për qind, pasuar nga tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor me rreth 25 për qind.

Brahim Selimaj nga Shoqata e



Ndërtimtarëve të Kosovës, që funksionon në kuadër të Aleancës Kosovare të Biznesit, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se humbjet në këtë sektor nga pandemia kanë bërë që bizneset ose ta shtyjnë afatin e kredive ose të mos i paguajnë fare kështu e fundit. "Kompanitë e prodhimit të materialit ndërtimor dhe ndërtuesit janë më të goditurit gjatë pandemisë, sepse nuk është sektor ushqimor që blihet çdo ditë. Gjatë kohës së pandemisë mund të them se deri në 20 për qind kanë falimentuar dhe numër një ka qenë, sepse çdo i dyti ka qenë i ngarkuar me kredi në bankat komerciale", thekson Selimaj.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në muajin mars, pas paraqitjes së rasteve të para me koronavirus, kishte marrë

vendim që bizneseve dhe individëve t'u mundësohet pezullimi i pagesave të kësteve të kredisë nga data 16 mars 2020 deri më 30 prill 2020.

Kryeshefi ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Baliaj, vlerëson se, pavarësisht rritjes së kredive të këqija, rreziku kreditor në sistemin bankar të Kosovës vazhdon të jetë i ulët. Ai tregon se turrja e madhe ekonomike në tremujorin e dytë të këtij viti për shkak të pandemisë ndikon që të ketë rritje të nivelit të kredive joperformuese, por aktualisht ky nivel vazhdon të mbetet brenda parametrave të menaxhueshëm.

Megjithatë, ai konsideron se është herët të nxirret një përfundim për pasojat e pandemisë Covid-19 mbi kualitetin e portofolit kreditor

edhe pse, si në çdo situatë të vështirësive ekonomike, sipas tij, mund të pritët edhe rritje në këtë aspekt, varësisht nga kapaciteti i ekonomisë së vendit për rimëkëmbje.

Sektori bankar në Kosovë vazhdon ta ruajë nivelin më të ulët të kredive joperformuese në rajon, thotë Baliaj. E gjithë kjo, sipas tij, ka ndodhur pasi politikat e kreditimit në Kosovë, të ushtruara nga bankat komerciale, janë të tilla që nuk e kanë parasysh vetëm rritjen e portofolit të kredive por, mbi të gjitha, ruajtjen e cilësisë së aseteve krahas rritjes dhe ofrimit të kredive për ekonominë e vendit.

Edhe sipas Raportit të Bankës Botërore për vitin e kaluar, Kosova qëndron e fundit karshi vendeve të rajonit sa i përket nivelit të kredive joperformuese.

Në Kosovë veprimtarinë e tyre e zhvillojnë dhjetë banka komerciale. Vlera e kredive të përgjithshme në këto institucione financiare ka arritur në 3.1 miliardë euro, me normë të interesit 6.1 për qind. Pavarësisht prej situatës me pandemi, Petrit Baliaj shprehet se bankat në Kosovë janë të sigurta dhe stabile në të gjithë indikatorët, por shton se është me rëndësi të vazhdohet qasja e kujdesshme për t'i tejkaluar sfidat, të cilat janë paraqitur gjatë pandemisë.

Njëkohësisht, sipas tij, është shumë me rëndësi që Qeveria e Kosovës dhe parlamenti të arrijnë t'i aprovonjë masat e nevojshme fiskale, financiare dhe ekonomike për ta rritur kërkesën agregate në ekonomi dhe për ta rritur qasjen në financa me kushte më të mira.



Deputeti Syla vendosi pllakë përkujtimore për Osman Vokshin dhe Emin Bashën

PEJË, 4 TETOR (ER) - Kryetari i OVLUÇK-së në Pejë, njëherësh deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e AAK-së, Gazmend Syla, ka nderuar dhe shënjuar nga një pllakë përkujtimore në vendin ku janë vrarë Osman Vokshi dhe Emin Basha.

Osman Vokshi u vra në demonstratë të vitit 1990, kurse Emin Basha u kidnapua dhe më pas u gjet i vrarë në janar të vitit 1999. "Në nderim të jetës dhe veprës së

Osman Vokshit, të vrarë në demonstratë gjithëpopullore të vitit 1990, shënjuam sot me pllakë përkujtimore vendin e rënies së tij. Po ashtu, sot shënjuam edhe vendin ku u kidnapua, e më pas u gjet i vrarë, Emin Basha, qytetar i respektuar në tërë qytetin e Pejës. Të dy këta burra zënë vendin e tyre meritore në përpjekjet tona për liri dhe çlirim. Lavdi u qoftë!", ka shkruar deputeti Syla në llogarinë e vet në "Facebook".

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 69 të shëruar dhe 59 raste të reja me Covid Asnjë i vdekur nga Covidi në 24 orët e fundit



Gjilan 8 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Fushë-Kosovë 3 raste, komuna Gjakovë 3 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Suharekë 2 raste dhe me nga një rast Drenas, Malishevë, Obiliq, Prizren dhe Viti. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!", ka njoftuar IKShPK-ja. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, duke numrin e rasteve me Covid-19, ka thënë se situata epidemiologjike në Kosovë vazhdon të jetë më e qetë se gjatë muajit të kaluar. Zemaj, ka thënë se laborja e numrit të të infektuarve në 24 orët e fundit është më e ulët se sa të shëruarave nga Covidi. Në këtë kontekst, ai ka thënë se pret nga profesionistët shëndetësorë që të jenë të përkushtuar në luftimin e vazhdueshëm të koronavirusit. "Në muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, situata epidemiologjike po vazhdon të jetë më e qetë se gjatë shtatorit. Pres që angazhimi kundër virusit Covid-19 të mos e ulë përkushtimin në sistemin e tërësishëm shëndetësor. Edhe sot laborja e numrit të të infektuarve për 24 orët e fundit është më e ulët se numri i të shëruarve. Nuk ka asnjë rast të vdekjes së pacientëve nga Covid 19, ndërsa 56 kanë rezultuar pozitivë, e 69 e kanë fituar betejën me Covid 19. Bashkë mund t'ia dalim!", është shprehur Zemaj.

Për dallim nga vendet evropiane, në Kosovë kohën e fundit ka rënie të numrit të rasteve të reja me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 56 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 56 persona nga ky virus. Sipas IKShPK-së, gjatë kësaj kohe asnjë person nuk ka ndërruar jetë si pasojë e infeksionit me virusin "Korona"

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 56 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 56 persona nga ky virus. Sipas

IKShPK-së, gjatë kësaj periudhe kohore asnjë person nuk e ka humbur jetën. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 567 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve

rezultojnë 56 raste pozitive. Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 15 814 raste nga 70 219 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 630 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 69 pacientë, ndërsa numri i

përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 13 856 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 328", ka njoftuar IKShPK-ja, duke njoftuar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve pozitive. "Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 16 raste, komuna Pejë 11 raste, komuna

Zemaj: Kosova në mesin e shtatë vendeve që kanë menaxhuar më së miri pandeminë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se Kosova është në mesin e shtatë vendeve të Evropës që kanë menaxhuar më së miri situatën epidemiologjike. "Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, po vazhdojmë të jetojmë me një realitet të ri të krijuar që nga marsi i këtij viti e do të vazhdojmë të jetojmë me të edhe për disa kohë sepse askush në botë nuk e ka të qartë deri kur do të kemi pandemi.

Deri te kjo situatë e menaxhueshme që e kemi, e kemi arritur së bashku, duke marrë përgjegjësi, por edhe duke

ndarë ato me aktorët e tjerë të rëndësishëm për luftimin e Covid-19. Tashmë jemi dëshmitarë që në dy javët e fundit jemi në mesin e shtatë vendeve të Evropës që kanë menaxhuar më së miri situatën epidemiologjike", ka thënë Zemaj, duke shtuar se kjo situatë është motiv shtesë për luftimin e pandemisë globale Covid-19. "Ky është motiv shtesë për punën dhe angazhimin e mëtejshëm të gjithsecilit. Kjo situatë e menaxhueshme është duke i dhënë mundësinë që planet dhe strategjitë t'i përgatisim në mënyrë të shpejtë për fazën tjetër, të vjeshtës dhe dimrit për



parandalimin e infektimit me Covid-19. Gradualisht kemi lehtësuar masat, por edhe kemi shtuar në terren inspektorë sanitarë në mënyrë që asgjë mos t'i lihet rastit dhe nga neglizhenca e ndokujt të kemi situatë jo të dëshirueshme.

Kam theksuar dhe theksoj përsëri, se nga lirimi i masave nuk

do të ketë më vërejtje, por reagim të fortë ndaj kujtqë nuk respekton masat anti-Covid", është shprehur Zemaj.

Në këtë aspekt, ai ka thënë se për shkak të situatës së favorshme në vendin tonë pritet të vijë rreth 20 mijë bashkatdhetarë. "Tashmë pritet se brenda 4 ditëve të ardhshme në Aeroportin e Prishtinës do të arrijnë rreth njëzet mijë bashkatdhetarë, andaj i bëj thirrje menaxhmentit në ANP që të ketë kujdes të shtuar ndaj diasporës dhe të ketë mbarevajtje të mirë sa i përket respektimit të masave anti-Covid. Me qëllim të shkëmbimit të

praktikave më të mira kundër Covid-19 dhe asistencë të ndërsjellë për përballimin e situatës së shkakuar nga koronavirusi, dje në Tiranë kemi nënshkruar edhe marrëveshjen me znj. Orgeta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", ka deklaruar Zemaj, duke shtuar se ka mirëpritur vendimin e Zvicrës për ta larguar karantinën për bashkatdhetarët që kthehen në Zvicër dhe vlefshmërinë e testeve tona që ka bërë ekipi i ekspertëve epidemiologjikë të Institutit të Shëndetit Publik "Robert Koch Institute".

Veseli bën thirrje që të vizitohen bjeshkët e Kosovës

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka bërë thirrje që gjatë fundjavës t'i vizitoni bjeshkët e bukura të Kosovës për t'i eksploruar florën dhe faunën e pasur të natyrës sonë. Ai ka thënë se në këtë mënyrë kontribuojnë

jmë edhe për fuqizimin e bizneseve të turizmit si dhe për prodhimin vendor bujqësor dhe blegtoral. "Këtë pjesë të brezit kufitar me Maqedoninë Veriore, mes Gurit të Zi dhe Vërtoptit, e kam kaluar për herë të fundit më 1993 me bashkëveprimtarë, duke sjellë pajisje ndër-

lidhjeje. Jam i gëzuar që këto shtigje që dikur kaloheshin nga luftëtarët e lirisë, të cilët transportonin shokët e plagosur e armatim, sot po shkelen gjithnjë e më shumë nga turistë vendës dhe të huaj", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



Pronari i kompanisë 'Meka': Prodhimet tona janë më cilësore se ato të importuara

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Pronari i kompanisë "Meka Halal Food" ka thënë se gjatë 28 vjetëve në këtë kompani kanë investuar në cilësi, për ta bindur opinionin se mund të sigurojnë prodhime të sigurta dhe cilësore. Piraj në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se prodhimet e tyre janë më cilësore se ato që importohen në Kosovë. "Për 28 vjet si ndërmarrje për therje dhe përpunim të mishit kemi investuar në cilësi për ta bindur opinionin se edhe ne shqiptarët kemi kapacitete për të ofruar cilësi dhe siguri të prodhimeve. Sot mburremi me rezultatit e arritur në këtë aspekt dhe ndihemi krenarë që prodhimet tona janë më cilësore se ato të importuara!", ka shkruar Piraj,

duke shtruar se për cilësinë e produkteve të "Mekës" tashmë e dinë edhe konsumatorët e shumtë. "Këtë tanimë e dinë mirë konsumatorët e prodhimeve 'Meka Halal Food'. Dilema kanë vetëm ata që nuk i kanë provuar prodhimet tona! Nuk janë fals pashtetat që po importohen në Kosovë, por pashteta 'Meka' ka cilësi të pakonkurrenshme dhe disa që assesi nuk e pranojnë këtë bëjnë propagandë se pashtetat e huaja po falsifikohen pa qenë në dijeni se sot falsifikimi është i pamundur sepse ka një gjurmim të prodhimeve nga origjina deri në tryezë të konsumatorëve. Pra, edhe nëse falsifikohet një produkt, ai nuk ka se si të shitet kur ka distributor të autorizuar!", ka shkruar Piraj.



Rukiqi: Mosmiratimi i Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike mund të shkaktojë dëme të pariparueshme

PRISHTINË, 4 TETOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka vlerësuar se vonimi i miratimit të Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike rrezikon që vendin ta shpije në një kolaps ekonomik. Ai ka thënë se dëmet që mund të shkaktohen nga vonesa e miratimit të këtij projektligji, siç janë mbyllja e bizneseve apo humbja e vendeve të punës, do të jenë të pariparueshme. "Sa më shumë që vonohet votimi i Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike kriza do të thellohet, pastaj është shumë vështirë të rikuperohet. Disa dëme janë të



pariparueshme. Nëse vijmë në situatë për t'u mbyllur mijëra biznese dhe mijëra vende pune,

ato nuk i rregullon asnjë ligj dhe përkrahje financiare. Ne jemi në fazë shumë delikate, e cila po

bëhet më e vështirë", ka thënë Rukiqi në një intervistë për "EO". Ai i ka kritikuar deputetët e Kuvendit që, sipas tij, nuk kanë vullnet për ta miratuar këtë projektligj. Rukiqi ka theksuar se mirëqenia e politikanëve dhe militantëve që kanë punësuar nuk është rrezikuar, por shumica e qytetarëve janë prekur nga kriza që ka shkakuar pandemia. "Ajo që unë po shoh te skena politike është dështimi për ta lexuar situatën. Shumica prej tyre nisen prej një pozicioni komod që e kanë. Përderisa ata nuk janë të ndikuar nga kriza, për këtë pjesë të skenës politike

pozitë dhe opozitë, nuk ka një lloj urgjence për të vepruar. Situata është shumë më ndryshe se është shkaktuar nga pandemia dhe janë globale. Këto raste i kemi këtu dhe mund të shumëfishohen dhe pastaj, nëse nuk intervenohet në kohën e duhur, me mekanizma të duhur, ne do ta shohim një kolaps ekonomik shumë shpejt", ka thënë Rukiqi. Sipas tij, në bazë të të dhënave zyrtare, krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit, për shkak të pandemisë, dëmi i përgjithshëm në ekonomi ose rënia e qarkullimit të bizneset ka arritur vlerën 1 miliard euro.

Linja hekurudhore Durrës - Prishtinë, projekt i domosdoshëm

PRISHTINË, 4 TETOR - Ndërtimi i hekurudhës që lidh Kosovën me Shqipërinë do të jetë mundësi e mirë për ta ulur koston e udhëtimit, ta stimulojë zhvillimin ekonomik dhe ta rritë rëndësinë strategjike të shtetit, ka thënë Sadulla Avdiu, profesor në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se investimi në transportin hekurudhor do ta lehtësojë qarkullimin e qytetarëve dhe mallrave për të dy shtetet, por edhe lidhjen me vende të rajonit. "Në krahasim me transportin rrugor, transporti hekurudhor është shumë më i lirë, kështu që Kosova përfiton shumë sepse shkurton distancën shumë", ka thënë Avdiu. Edhe Halim Gjergjizi, profesor i politikave ekonomike në Kolegjin "Dardania", thotë se me ndërtimin e linjave hekurudhore Kosova largohet nga izolimi në këtë fushë. Ai konsideron se, përveç leverdisë që do ta kenë qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë, linja hekurudhore rrit edhe interesimin edhe për investitorët e huaj. "Transporti hekurudhor rrit rëndësinë specifike të shtetit. Kosova ka qenë e mbyllur me dekada sa i përket

përgatitjen e plotë të studimit të fizibilitetit dhe sigurimit të fondeve nga ShBA-ja, BE-ja dhe buxhetet e të dy qeverive. Sadullah Avdiu, profesor i lëndës "Projektimi i hekurudhave", në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se investimi në transportin hekurudhor do ta lehtësojë qarkullimin e qytetarëve dhe mallrave për të dy shtetet, por edhe lidhjen me vende të rajonit. "Në krahasim me transportin rrugor, transporti hekurudhor është shumë më i lirë, kështu që Kosova përfiton shumë sepse shkurton distancën shumë", ka thënë Avdiu. Edhe Halim Gjergjizi, profesor i politikave ekonomike në Kolegjin "Dardania", thotë se me ndërtimin e linjave hekurudhore Kosova largohet nga izolimi në këtë fushë. Ai konsideron se, përveç leverdisë që do ta kenë qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë, linja hekurudhore rrit edhe interesimin edhe për investitorët e huaj. "Transporti hekurudhor rrit rëndësinë specifike të shtetit. Kosova ka qenë e mbyllur me dekada sa i përket



infrastrukturës hekurudhore. Tashmë me këtë linjë Kosova bëhet nyje e rëndësishme në pjesën e Evropës. Infrastruktura rrugore është parakusht për investime dhe zhvillim ekonomik", ka thënë Gjergjizi. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në Tiranë ka thënë se gjatë muajve të fundit kanë punuar në vazhdimësi që të jenë një qeveri e cila shihet si kontribuuese e paqes dhe stabilitetit në rajon. "Përmes

këtij projekti besoj se do të ndërrojë komplet konjektura ekonomike në rajon dhe më gjerë", ka thënë Hoti. Por, si do të ndërtohet kjo linjë, sa do të kushtojë, a do të riparohet hekurudha e vjetër Prishtinë-Prizren, apo do të ndërtohet linje e re, ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të kompanisë "Infrakos" nuk ka qenë i qasshëm për këto pyetje. Përveç linjës hekurudhore që lidh Kosovën dhe Shqipërinë, në vitin

2013 ka përfunduar autostrada 'Ibrahim Rugova'. Ndryshe, autoritetet në Prishtinë vazhdimisht kanë konfirmuar gatishmërinë për realizimin e projekteve të linjave hekurudhore dhe rrugore me vendet e rajonit, siç është linja hekurudhore Durrës-Prishtinë-Nish, projekt ky që lidh Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë. Projektet rajonale hekurudhore ishin diskutuar edhe në Procesin e Berlinit, pjesë e të cilit është edhe Kosova.

Hapet sezoni turistik vjeshtë-dimër, institucionet premtojnë mbështetje për turizmin

Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë bërë hapjen e sezonit turistik vjeshtë-dimër. Në aktivitetin e mbajtur në Brod të Dragashit, përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale janë zotuar se do ta mbështesin zhvillimin e turizmit. Zëvendëskryeministrja Albulena Balaj-Halimaj dhe ministrat Vesel Krasniqi dhe Blendi Klosi kanë theksuar se zhvillimi i turizmit nënkupton edhe hapje të vendeve të reja të punës



DRAGASH, 4 TETOR - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka organizuar të dielën Ditën Botërore të Turizmit, me ç'rast është bërë edhe hapja e sezonit turistik vjeshtë-dimër. Ky aktivitet është mbajtur në moton "Të ecim shtigjeve të Dardanisë". Në këtë aktivitet i cili është mbajtur në Brod të Dragashit është thënë se fuqizimi i turizmit do të ndikojë drejtpërdrejt në krijimin e vendeve të punës. Në këtë kontekst, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe Shqipërisë janë zotuar se do ta mbështesin sektorin e turizmit. Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka thënë se qeveria Hoti do ta ketë prioritet turizmin. Ajo ka vlerësuar se zhvillimi i turizmit sjell fitime ekonomike dhe vende të reja të punës. "Sot jemi për ta shënuar Ditën Botërore të Turizmit që hap zyrtarisht turizmin në Kosovë dhe uroj të kemi sukses pavarësisht gjendjes në të cilën jemi. Ky takim po mbahet pas dy ditë të mbledhjes së dy qeverive tona që u takuam në Tiranë dhe uroj që si ajo ditë që ishte produktive edhe ky takim të dalë me rezultat të mira. Situata krijon shumë rreziqe për turizmin dhe

zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i turizmit sjell fitime ekonomike dhe vende të reja të punës. Si qeveri do t'i japim prioritet të veçantë turizmit vjeshtë-dimër në Kosovë", është shprehur Balaj-Halimaj. Zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj ka kërkuar që shqiptarët e Shqipërisë t'i kalojnë pushimet vjeshtë-dimër në Kosovë. Ndërsa ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka thënë se së bashku me homologun shqiptar, Blendi Klosi, janë duke u përpjekur që t'i promovojnë vendet turistike të Kosovës dhe Shqipërisë. Me këtë rast, Krasniqi ka ftuar bizneset që të investojnë në fushën e turizmit në Kosovë dhe Shqipëri. "Duke parë se turizmi në vendet tona ka potencial të madh për t'u ofruar vizitorëve, ne dy ministrat jemi marrë vesh që ta bëjmë promovimin e vendeve së bashku. Jemi duke punuar për të krijuar guida për vizitorët. Sektori i turizmit është mjaft i rëndësishëm në vendin tonë dhe unë jam përkushtuar që përmes dikasterit që drejtoj, duke rritur buxhetin në fushën e turizmit. I ftoj bizneset nga vendi ynë dhe jashtë që të investojnë në fushën

e turizmit në këto dy vendet", është shprehur Krasniqi. Në anën tjetër, ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, ka shtuar se kufiri administrativ nuk duhet të jetë problem për promovimin e destinacioneve turistike në mes të dy shteteve. "E kemi thënë shpesh se si turizmi në vendet tona duhet të shndërrohet në një industri e cila çdo ditë mund të ofrojë punësim dhe, në fund të fundit, ne kemi shumë nevojë të promovojmë në mënyrë të përbashkët një destinacion që nuk ka arsye të ketë ndarje nga një kufi administrativ", ka thënë Klosi. Më tutje, kryetari i Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, ka thënë se Brodi është qendra më e madhe turistike dhe ofron kushte të mira për skijim. "Dragashi

është e vetmja komunë që është e vendosur brenda maleve. Terrenet për skijim janë shumë të përshtatshme. Brodi është qendra më e madhe dhe kushtet janë të mira", ka thënë Shabani. Kurse kryetari i Bashkësisë së Vlorës, Dritan Leli, ka thënë se mbledhja e dy qeverive ka treguar që ka sjellë produkt konkret sa i takon turizmit. "Radha jonë është që në sezonin turistik vjeshtë-dimër t'i vizitojmë bjeshkët dhe të vizitojmë shqip. Mbledhja e dy qeverive tregoi që ne ta flasim gjuhën e përbashkët dhe të bëjmë punë që shoqërojnë produkt", është shprehur Leli. Në këtë aktivitet ka qenë i pranishëm edhe kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka. Ai ka thënë se për këtë vit prioritet i komunës që drejton ka qenë zhvillimi i turizmit,

mirëpo pandemia ka pasur ndikimin e saj. "Turizmi është sektor shumë i rëndësishëm për Kosovën. Krijimi i vendeve të punës nuk është vetëm në hoteleri, por edhe në bujqësi dhe në prodhimin e ushqimit. Ne si komunë e kemi shpallur prioritet zhvillimin e turizmit, por pandemia na goditi", është shprehur Haskuka. Krejt në fund, ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, ka thënë se mbledhja e dy qeverive ka qenë e rëndësishme për fushën e ekonomisë mbarëshqiptare. "Mbledhja e fundit është e rëndësishme për një bashkëpunim në fushën e ekonomisë. Ka shumë rëndësi që ne të shikojmë për të ardhmen dhe kapacitet hoteliere", ka deklaruar ambasadori Minxhozi.

PDK-ja kritikon LDK-në dhe LV-në për qeverisjen në Prishtinë: S'kanë vizion, çdo vit tepron mbi 20 për qind e buxhetit

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Partia Demokratike në Prishtinë ka mbajtur të dielën konferencë për media, në të cilën zyrtarët e saj kanë folur për buxhetin e Komunës së Prishtinës, i cili është miratuar ditë më parë si dhe mungesën e vizionit që tradicionalisht po përcjell çdo buxhet nga të gjitha partitë që kanë udhëhequr kryeqytetin. Deputetja nga radhët e PDK-së, Eliza Hoxha, ka thënë se që nga shpallja e pavarësisë, por edhe më herët, "kemi pasur një buxhet të Prishtinës të dizajnuar për komunën, por jo për qytetarët". "Buxheti i Prishtinës

tradicionalisht nuk përmbush nevojat e qytetarëve, të familjeve, prindërve, fëmijëve dhe gjyshërve tanë. Si pasojë, kemi një Prishtinë të paorganizuar dhe jofunksionale që, në vend se të na lehtësojë, ajo na ka rënduar jetën e secilit prej nesh", ka thënë Hoxha. Sipas saj, buxheti i Komunës së Prishtinës nuk ka paraparë asnjë vijë buxhetore për përballjen me Covid-19. "Ndërmarrësit e Prishtinës edhe një herë do të jenë të vetëm në ballafaqim me krizën, pasi asnjë linjë buxhetore nuk është ndarë për ta. Përkundrazi, kemi zvogëlim të



buxhetit për zhvillim ekonomik nga 500 mijë në 100 mijë euro", ka thënë Hoxha. Sa i përket realizimit të buxhetit ndër vite, Leutrim Retkoceri, asamblist i PDK-së në Prishtinë, ka thënë se Prishtina që nga paslufta është kampione e tepricave buxhetore apo suficitit. Sipas kësaj partie, për shkak të planifikimeve të, siç kanë thënë, të dobëta nga të gjitha qeveritë e deritanishme në Prishtinë, si nga LDK-ja e po ashtu nga Vetëvendosja, mesatarisht 20 për qind e buxhetit apo rreth 17 milionë euro i humbin Prishtinës në suficit çdo vit.

Veseli në Dragash përruron rrugën e asfaltuar që afron me Tetovën

DRAGASH, 4 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka qëndruar për vizitë në Komunën e Dragashit, ku ka vizituar disa projekte të mëdha infrastrukturore dhe turistike që po përmbillen nga qeverisja lokale.

Ai ka vizituar rrugën e porsaasfaltuar që lidh këtë pjesë të Dragashit me njërin nga zonat me potencial turistik në brezin kufitar, prej Gurit të Zi drejt Tetovës.

Veseli ka kujtuar me nostalgji vitet '90 se si këto rrugë që dikur i ka kaluar me shumë shokë për çlirimin e vendit, sot po kthehen në rrugë zhvillimi dhe turizmi. "Kryetarin Shaban Shabani e përgëzoj për korrektësinë, për

një punë të nderhme, për një punë jashtëzakonisht të suksesshme si kryetar i Komunës së Dragashit. Nga Autostrada e Kombit po lidhet shumë shpejt edhe Dragashi, që do të bëhet një urë lidhëse edhe me Maqedoninë e Veriut. Do të dalim në Tetovë. Ky projektion i rrugës ka dimension të shumanshëm të zhvillimit të Komunës së Dragashit. Nuk është vetëm për komunikim ndërmjet vendbanimeve, pasi kjo pjesë është zonë turistike. Projekti i kryetarit Shabani është që të vazhdoen pistat e skijimit. Do të vazhdojmë me investimet edhe në pjesë të tjera sa i përket promovimit si zona turistike, zhvillimit të blegtorisë dhe ekonomisë, që njerëzit të



mos largohen nga kjo pjesë e cila është jashtëzakonisht e bukur", ka thënë Veseli, duke

shtuar se është i lumtur që ky projekt ka pasur të përfundojë vitin e ardhshëm, por puna e

kryetarit Shabani ka bërë që këto punime të përfundojnë një vit më herët.

QKMF-ja në Kaçanik furnizohet me autoambulancë të re

KAÇANIK, 4 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, dhe drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Diana Reka, dorëzuan çelësat e autoambulancës së re drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik, Sinan Zeneli. Me këtë rast, kryetari Ilazi ka theksuar se kjo autoambulancë e re është investim komunal dhe është pjesë e politikës komunale për krijimin e kushteve sa më cilësore në shëndetësi. Po ashtu, ai ka përgëzuar stafin mjekësor për menaxhimin e mirë të pandemisë ku, sipas tij, komuna që drejton ka hyrë në mesin e pesë komunave për menaxhimin e mirë të



situatës.

Drejtori i QKMF-së në Kaçanik, Sinan Zeneli, ka pohuar se kjo autoambulancë do të plotësojë

nevojën e madhe për këtë institucion, ku për shkak të pandemisë Covid është shtuar edhe fluksi i punëve.

Në Llazicë të Malishevës asfaltohen edhe tri rrugë të reja

MALISHEVË, 4 TETOR (ER) - Në fshatin Llazicë të Malishevës ka filluar asfaltimi i tri rrugëve të reja. Asfaltimi i këtyre rrugëve është pjesë e investimeve kapitale në ndërtimin e infrastrukturës së përgjithshme në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës. Asfaltimin e rrugëve e ka parë nga afër drejtori për Urbanizëm, Ahmet Morina, i cili është takuar edhe me banorët që jetojnë në këto lagje

ku janë asfaltuar rrugët. Morina ka bërë me dije se të tri rrugët kanë një gjatësi prej 700 metrave dhe asfaltimi i tyre është mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Drejtori Morina i ka uruar banorët për rrugët e reja dhe ka thënë se "si qeveri komunale janë të përkushtuar për realizimin e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Komunës së Malishevës në të gjitha vendbanimet e saj".



LDK-ja kritikon qeverisjen e Mytaher Haskukës për korrupsion dhe nepotizëm



PRIZREN, 4 TETOR (ER) - Dega e Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK) në Prizren ka kritikuar qeverisjen e Mytaher Haskukës në këtë qytet. Sipas Degës së LDK-së në Prizren, raportit i auditorit ka gjetur shkelje në Drejtorinë e Kulturës, shkelje për të cilat përgjegjësia më e madhe është e kryetarit të komunës, i cili, edhe përkundër kritikave të shoqërisë civile, ka lejuar që këtë drejtori ta udhëheqë një person i dënuar me aktvendim gjyqësor për falsifikim dokumentesh. "Subvencionimi i OJQ-ve sipas raportit të auditorit është përcjell me këto parregullsi: Mungesa e përfshirjes së kriterëve minimale në shpalljen publike rezultoi me

diskriminimin e të interesuarve dhe kufizim të konkurrencës. Përzgjedhja e përfituesve, pa i plotësuar kriteret e vendosura në shpalljen publike, ka reflektuar trajtim jo të barabartë të aplikuesve dhe komuna rrezikon financimin e përfituesve të papërgjegjshëm përmes fondeve publike. Përtej diskriminimit, kufizimit të konkurrencës, përzgjedhjes së përfituesve pa i plotësuar kriteret që reflekton në trajtim të jobarabartë, ka edhe një fakt interesant që nuk e përmend auditori. Ka mungesë të transparencës për shumatat e ndara për OJQ-të, mungesa kjo përbrenda së cilës ka dyshime të bazuara se ka edhe korrupsion dhe nepotizëm",

thuhet në reagimin e LDK-së në Prizren. Sipas kësaj partie, ndarja e fondeve për "vëllezër motra e miq" të zyrtarëve komunalë kulmon me ndarjen e mjeteve për organizatën e ish-drejtorit, secilin vit duke e rritur shumën.

Dega e LDK-së shpreh dyshimet e hapura se në këtë mungesë transparence fshihen korrupsioni dhe nepotizmi. "Dega e LDK-së në Prizren beson se prokuroria qysh vitin e kaluar i ka hetuar shqetësimet e komunitetit kulturor të cilat janë rekomandime të auditorit dhe, gjithashtu, beson se do ta vazhdojë hetimin e këtyre politikave diskriminuese", thuhet në reagimin e kësaj partie.

Në St. Gallen u prezantua libri “Bleibende Spuren”

Isuf SHERIFI

Në Bibliotekën e Qytetit St. Gallen u bë prezantimi i librit “Bleibende Spuren” (“Gjurmë të përhershme”) i autores shqiptare me prejardhje nga Kosova, Basrie Murati-Sakiri.



Libri është botuar vitin e kaluar nga Shtëpia botuese nga Zürich, “Rotpunktverlag”. Prezantimi në St. Gallen është i 10-ti me radhë që e ka pasur deri më tani në Zvicër, gjë që flet shumë për vlerat e librit dhe interesimin e vazhduar që po e tregojnë për të lexuesit


dhe institucionet e ndryshme kulturore. Për rrjedhojë, edhe mediat e shumta, si të karakterit kulturor, judikativ, ashtu dhe ato informativ, kanë publikuar që nga botimi i librit prezantime dhe vështrime të ndryshme mbi të, përfshirë edhe bisedat dhe intervistat tematike me autoren.

Përmes këtij libri autorja Murati-Sakiri flet për jetën e saj si gjimnaziste; angazhimin politiko-patriotik që në rininë e hershme, për lirinë dhe Republikën e Kosovës; përndjekjet e vazhdueshme të saj dhe bashkëveprimtarëve, pjesëtarë të “Çetës së Llapit”, ku bënte pjesë ajo; vrasjen e bashkëveprimtarit, heroit Ali Ajeti, si dhe përjetimin e vrasjes së babait të saj nga ana e forcave serbe në betejën e Llapashticës.

Me mirënjohje të veçantë autorja flet për të gjitha ato familje që i përkrahën dhe strehuan gjatë qëndrimit afër tremujor fshehur në mal. Duke dëgjuar me vëmendje fragmente të lexuara nga vetë autorja, ndeshësh faktin se ajo në libër tregohet shumë modeste dhe e çiltër. Nuk flet vetëm për dramën e saj personale, nuk shfaqet vetëlavdëruese, por në fokusin kryesor shpërfaq fatin e rëndë të Kosovës, përkatësisht shqiptarëve të robëruar nën ish-Jugosllavi. Në libër, një pjesë të konsiderueshme e zë edhe



periodha e ekzilit të detyrueshëm, shkak i ndjekjeve për t'u burgosur, të autores në Zvicër, e përfshirë



në pjesën e dytë, e cila është po aq interesante sa dhe vetë koha e jetuar në vendlindje. I shkruar në formë ditari, me një

narracion që secilin lexues e merr me lehtësi në udhëtimin e vet, në këtë libër tragjeditë nuk rrëfehen vetëm me doza mllafi e mërzie, por edhe me gjuhën e humorit të lehtë, që herë pas here të bën për të qarë dhe qeshur njëherësh. Shpresa, optimizmi, besimi i paluhatshtëm në rezultatin pozitiv final të luftës së Kosovës, çlirim dhe lirinë, e përshkojnë librin edhe në momentet më të rënda që përjeton autorja, qoftë në atdhe, qoftë në mërgim, ku ballafaqohet me sfidat shtesë që shtrojnë vendi dhe shoqëria e huaj.

Prezantimin e librit, në formë interaktive me të pranishmit, si dhe bashkëbisedimin letrar me autoren, e udhëhoqi gazetarja dhe studiuesja e mirënjohur e gjermanistikës, Eva Bachmann. Në fund, autorja si dhe organizatorët i falënderuan të pranishmit për pjesëmarrjen dhe interesimin e treguar.



Komuna e Lipjanit tani edhe me shtigje moderne të ecjes

LIPJAN, 4 TETOR (ER) - I pari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së me bashkëpunëtorë dhe zëvendësiministrja MAPL-së, Makbule Shkodra dhe qytetarë të tjerë, kanë bërë përrurimin e shtigjeve të ecjes në Lipjan. Kryetari Ahmeti vlerësoi lart këtë projekt duke thënë se ky është një projekt modern dhe kjo është vetëm faza parë. “Do vazhdojmë edhe 2.7 km në fazën e

dytë për t'u krijuar hapësirë dhe mundësi për rekreacion qytetarëve tanë. Qytetarët e Lipjanit do të kenë edhe një hapësirë tjetër me kushte shumë të mira për rekreacion dhe ecje”, ka thënë kryetari Ahmeti. Pas përrurimit, shtë mbajtur edhe vrapimi “Vrapimi i krushqve”, që është organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Nderohet luftëtari i lirisë Jusuf Shalaku-Cufa

OBILIQ, 4 TETOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Obiliqit, Ibush Mjekiqi, së bashku me kryesuesin e Kuvendit Komunal, Burim Gërguri, bashkëveprimtarët dhe familjarët e heroit, asamblistë dhe ekzekutivin, kanë bërë homazhe duke nderuar jetën dhe veprën e luftëtarit të lirisë

Jusuf Shalaku - Cufa. Në fjalën e tij, kryesuesi i KK-së në Obiliq, Burim Gërguri, ka vlerësuar lart kontributin e luftëtarit të lirisë, Jusuf Shalaku-Cufa, duke thënë se veprat e heronjve për lirinë e vendit do të mbesin të pavdekshme dhe do të përcillen ndër breza.



Recension për librin “Pranverë e helmuar”, të autorit Hazir Mehmeti

“PRANVERË E HELMUAR”, NJË VEPËR DOKUMENT KOHE



Prof. dr. Eqrem M. ZENELAJ

Në përmbajtjen e librit “Pranverë e helmuar” shihet mirë një periudhë e rëndë që përjetoi kombi shqiptar në Kosovë. Fëmija është e ardhmja e një kombi, armiku e dëshironte helmimin e së ardhmes së kombit shqiptar. Që në hyrje të librit me argumente përkujtohen krimet serbe ndaj shqiptarëve në trojet e tyre etnike të organizuara dhe dirigjuara nga pushteti shfarosës serb i programuar nga akademikët dhe kisha ortodokse serbe. Faktet e mbledhura në arkivat dhe bibliotekat e vendeve të ndryshme, librit i dhanë dimensione shkencore të pa kontestueshme. Kronologjia e renditjes së fakteve përkujtohen me saktësi që nga “Golgota Shqiptare” (Albanische Gulgota) e Leo Freundlich deri tek ditari personal i autorit. Libri bazohet në katër shtylla të fuqishme të një tërësie kohore të përmbajtjes: Rrethanat e


represionit të pushtuesve serb para dhe gjatë helmimit; dokumente e shkrime nga shtypi botëror; faktet nga hulumtimet shkencore për praninë substancave helmuese kimike në mostrat e fëmijëve të helmuar; ditari personal i autorit në kohën e helmimeve duke qenë vetë dëshmitar i ngjarjeve të rënda. Me intuitë të një hulumtuesi me përvojë, Mr. sci. Hazir Mehmeti, në hyrje të librit ofron shkrime e dokumente relevante nga shumë autorë kombesh të ndryshme duke përfshirë këtu edhe serbë lidhur me planet serbe të zhdukjes së shqiptarëve. Këto dokumente flasin mbi aktivitetin e gjenocidit serb të vazhdueshëm që nga Plana, Nishi, Vranja, Sanxhaku, Kosova. Këto lidhen në kontekst kohe me ngjarjet në vijim që nga dokumenti “Akuzat kundër vrasjes së popullit shqiptar 1913”, duke vazhduar deri në helmimin e fëmijëve shqiptarë si hapi i radhës për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre shekullore. Shtypi i kohës dhe dokumente nga aktiviteti i japin librit aktualitet të qëndrueshëm si njëra nga të parat e tillë gjithëpërfshirëse dhe e veçantë rreth helmimit të fëmijëve shqiptarë në Kosovë. Ndryshimet kushtetuese me dhunë nga

Serbia në vitin 1989, pastaj segregacioni ishin hapat që i paraprinë helmimit. Këto ngjarje paraqitën në libër me syrin e hulumtuesit e publicistit, i cili që herët nga koha e punës së tij në Qendrën Shkollore ndau fatin me nxënësit, prindërit dhe kolegët e tij. Rrethanat e rënda paraqiten shkurtas por me argumente qoftë nga personalitet e njohur të kohës apo dokumentet dhe shkrimet e shtypit periodik e ditore, libra të shkruar deri tani rreth helmimit. Sulmi që i bëhet shkollës shqiptare, ndryshimi me dhunë i plan programeve të mësimin në gjuhën shqipe janë vetëm fillimi i aktivitetit shovinist serb. Vendimi i ndërprerjes së financimit të arsimitarëve të shkollave të mesme ishte presioni i shoqëruar me dhunën e vazhdueshme serbe për të pranuar plan programet serbe dhe vetvetiu nga kjo rrjedh pranimi i ndryshmeve në kushtetutën serbe e cila hoqi autonominë Kosovës. Në fakt, libri sjell gjithashtu sekuenca nga qëndresa e mësimdhënësve shqiptarë në kolektivet e tyre, duke u organizuar si të pavarur nga sistemi serb i cili mbrohej nga struktura e vjetër. Kështu ishte edhe në shkollën ku Hazir Mehmeti punonte dhe ishte pjesë e organizimeve të



fuqishme brenda kolektivit ndër më të mëdhenjtë në gjithë vendin. Këto rrethana të detajuar autori i saktëson edhe nga shkrimet e kohës, raportet e mbajtura nga mbledhjet dhe ditarin e tij personal. Përballja me helmimin nuk ishte e lehtë, kërkonte organizim, mençuri e trimëri. Pasojat në këto rrethana i bartën përveç të helmuarve, edhe rrethi shkollor, rrethet e shërbimeve shëndetësore. Shkollat, shtëpitë e shëndetit, spitalet u morën nën kontrollin e policore serbe. Çdo ditë kishte protesta, arrestime, burgosje, kurse marrja në “biseda informative” ishte e përditshme, këtë e përjetoi edhe autori i librit. Plaçkitje e barërave, arrestimet e të helmuarve, atyre që dhanë ndihmë ishin të përditshme, këtë e përjetuan spitalet, shërbimi shëndetësor, Kisha Katolike Shqiptare në Ferizaj, Binçë e gjetkë duke penguar shërimin e fëmijëve të helmuar. Mr. sci. Hazir Mehmeti në librin e tij ofron fakte lidhur me rezultatet shkencore nga analizat laboratorike në të cilat u vërtetua prania e substancave neurotoksike. Të gjitha analizat laboratorike të

bëra në Zagreb, Paris e gjetiu tregojnë, se është fjala për helmime. Këtë e pohojnë mjekët specialist shqiptarë në bazë të simptomave, por edhe toksikolog ndërkombëtarë me analizat e tyre laboratorike: Dr. Aubin Heyndrickx, Dr. Franjo Plavsiç, Dr. Bernard Benedetti, Grajgut, Graves, Dolenc. Gjetja e substancës në gjashtë mostra të shtatë fëmijëve të helmuar në Kosovë në analizat e specializuara u zbulua substanca DIMETIL-PHOSPH-DITIONAT (DM-PP), Dr. Franjo Plavsiç, në simpoziumin lidhur me helmimet në Zagreb me 9 qershor 1990 etj. Pa dyshim kjo vepër do jetë edhe një dokument dëshmi kohëve mbi krimin e rëndë serb të helmimit të tetë mijë fëmijëve shqiptarë, krim i cili nuk u dënua, krim i cili nuk do harrohet asnjëherë në jetën e kombit shqiptar. Ditari i tij personal i përshkrimit dhe përjetimit të helmimit të nxënësve flet në detaje dhe mbetet dëshmi me vlerë ku flitet jo vetëm për helmimin, por edhe për represionin, arrestimet, marrja në “pyetje” nga organet e sigurimit serb të cilat i përjetuan aktivistët mes tyre edhe autori. Ditari



Mr. sci. Hazir Mehmeti

personal tridhjetë vjet i ruajtur me kujdes do duhej të ishte pjesë e arkivave tona që nesër gjeneratat të mësojnë e edukohen në frymë e respektit dhe dashurisë ndaj kombit, historisë së tij të vështirë, por të lavdishme.

Vepra "Pranverë e Helmuar" e autorit Mr.sci.Hazir Mehmeti, është vazhdim i suksesshëm i hulumtimeve të tij shumëvjeçare. Ai u dallua si pedagog punëtor në Kosovë, Austri, si publicist dhe shkrimtar ku punimet e tij të botuara në shumë gazeta kanë nxjerrë emrin e tij si figurë e respektuar.

Mr.sci.Hazir Mehmeti është emër i njohur për veprimtarinë kombëtare për publicistikën dhe arsimin shqip në Austri. Ai është bashkëpunëtor i dhjetëra gazetave dhe revistave të shumta në diasporë deri në SHBA si dhe në trojet shqiptare.

Hazir Mehmeti është autor i abetares së parë për nxënësit shqiptarë në Austri dhe i teksteve të tjera; bashkautor i disa teksteve mësimore për diasporë; pjesëmarrës në studimet rreth përvojës në didaktikën bashkëkohore; pjesëmarrës në hulumtime metodologjike për arsimin e edukim me tekstet te reja mësimore; drejtues i faqes së internetit për materiale mësimore në gjuhën shqipe pranë Ministrisë së Arsimit në Austri; pjesëmarrës i shumë projekteve kulturore, pedagogjike; pjesëmarrës i shumë seminareve profesionale si ligjërues dhe shumë projekte. Mr.sci. Hazir Mehmeti ka qenë për shumë vite njëri nga drejtuesit e Shoqatës së Mësuesve Shqiptarë në Austri, por dhe kryetar i saj. Ai është anëtar i Asociacionit të gazetarëve profesionist botëror me seli në Florida; anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve në Diasporë; është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë "Aleksandër Moisiu" në Austri. Autor i disa veprave letrare e artistike të përkthyer në gjermanisht dhe rumanisht; autor i

monografive dhe veprave hulumtuese me vlera për historinë dhe kulturën kombëtare.

Për punën shembullore në arsim dhe krijimtari, Akademia e Shkencave Pedagogjike e Shqipërisë e pranon anëtar të saj, ndër të parët nga diaspora. Prof. Dr. Musa Kraja dhe Emirjona Kraja shkruajnë librin Monografi Social Pedagogjike "Mësues e Krijues në Diasporë, Hazir Mehmeti"-Tiranë, 2016.


Ndër veprat e tij e cila ka dimension shkencore në relacionin e marrëdhënieve Shqiptaro-Austriake, "Studiues Austriakë e Shqiptarë në Austri", në të cilin pasqyrohen raporte shekullore mes dy kombeve në rrafshin e gjuhës, artit dhe kulturës. Kjo vepër u prit jashtëzakonisht mirë nga të gjitha nivelet intelektuale e akademike edhe në Austri, një kontribut në vlera të përgjithshme të ngritjes së frymës së bashkëpunimit ndërkulturor në Austri dhe miqësisë Austro-Shqiptare.

Përsëri kthehem te vepra me e re e Mr.sci.Hazir Mehmetit: "PRANVERË E HELMUAR", ku ka edhe shumë për të thënë, por po e përmbylim me një thënie të Marko Tula Ciceronit: "Nxitja më madhe e kriminit është të mos e ndëshkosh". Krimi serb i helmimit i pasqyruar në "Pranverë e helmuar" kërkon dënimin e tij, kurse harrimi i tij është pajtimi i turpshëm gjunjëzues i yni. Ne nuk do lejojmë këtë! E kemi detyrim kombëtar!

Vepra e Mr.sci.Hazir Mehmetit është një thesar i kulturës dhe i memories së vuajtjeve kombëtare historike shqiptare dhe si e tillë kjo vepër zë një vend të rëndësishëm në literaturën e Historisë Kombëtare Shqiptare.

Së fundmi, Zotit Mr.sci. Hazir Mehmeti, i urojmë suksese, në prurjet e reja kulturo-historike, ndërsa librit të tij me titull: "PRANVERË E HELMUAR", i dëshirojmë dhe urojmë shtrirje të gjerë në trojet shqiptare dhe jo vetëm!

Mosleximi: Si pasqyrohet në fytyrë?



**Nga: Lin YUTANG
Përktheu: Aurel PLASARI**

"Formulën më të mirë për ç'i përket leximit e ka caktuar, për mendimin tim, Huang Shanku, poet dhe mik i Su Tung Po-së: 'Një lexues që nuk ka lexuar asgjë për tri ditë dallohet ngaqë kuvendimi i tij: nuk ka shije dhe deri edhe fytyra e tij bëhet për të mos u parë në pasqyrë'. Me këtë ka dashur të thotë që leximi i jep njeriut një hir dhe një shije të veçantë, çfarë në fund të fundit është edhe vetë synimi përfundimtar i leximit. Vetëm të lexuarit me këtë objektiv mund të quhet art. Nuk duhet lexuar për të përmirësuar kulturën vetjake, sepse kur fillon të mendosh për të përmirësuar kulturën tënde,

gjithë kënaqësinë e leximit e ka marrë lumi. Përkundrazi, të lexosh për të zhvilluar njëfarë hiri vetjak dhe njëfarë shijeje në të kuvenduarit është, simbas Huangut, e vetmja metodë e pranueshme leximi. Afërmendsh që shprehja e hirit vetjak duhet interpretuar si diçka e ndryshme prej bukurisë fizike. Sepse ajo që Huangu ka dashur të thotë me 'për të mos u parë në pasqyrë' nuk ka të bëjë me bukurinë fizike. Ka fytyra të shëmtuara që të bëjnë për vete kur i vështron, siç ka fytyra të bukura pa pikë shijeje. Më i bukuri i shkrimtarëve perëndimorë mua gjithnjë më është dukur Gilbert Keith Chestertoni. Se ç'dreq grumbullim mustaqesh, qelqesh të syzeve, vetullash

mrekullisht të dendura dhe ndërthurjeje rrudhash aty tek vetullat takohen! Ndihet që brenda atij balli duhej të ketë pasur një sasi idesh që vlonin, të gatshme për të shpërthyer në çdo çast prej atyre sysh aq çuditërisht depërtues. Është një nga ato fytyra që Huangu do ta kishte quajtur të bukur; një fytyrë që nuk mbahet në formë prej pudrës e prej të kuqit, por prej fuqisë së mendimit. Mandej, sa për shijen e të kuvenduarit, gjithçka varet nga mënyra e të lexuarit. Nëse lexuesi e shijon atë çfarë lexon, shija do të shfaqet edhe në kuvendimin e tij dhe, nëse kuvendimi i tij ka shije, do të kenë shije edhe shkrimet e tij". /Lin Yutang, The Importance of Living, fq. 354-355/

Poetja shqiptare Fatime Kalimashi, nderohet me titullin "Ambasadore e Paqes" nga Federata për Paqen Universale



Poetja shqiptare Fatime Kalimashi, e cila jeton në Zvicër, merr titullin "Ambasadore e Paqes" nga Federata për Paqen Universale.

Lajmin e bëri të ditur vetë poetja përmes një statusi në rrjetin social Facebook.

Më poshtë mund të lexoni statusin e plotë të saj. Federata për Paqen Universale u jep titullin «Ambasador i Paqes» personalitetëve shembullore që jetojnë për të tjerët dhe u përkushtohen aktiviteteve me qëllim promovimin e vlerave

morale universale, një jetë të qëndrueshme familjare, bashkëpunim ndërfaqet, harmoni midis Kombeve, media të përgjegjshme, ripërtëritja e Kombeve të Bashkuara dhe vendosja e një kulture paqej.

Duke kapërcyer pengesat racore, kombëtare dhe fetare, Ambasadorët për Paqë kontribuojnë në realizimin e ëndrrës shekullore të njerëzimit: një botë e bashkuar dhe paqësore në të cilën harmonizohen dimensionet shpirtërore dhe materiale të

jetës.

Federata për Paqen Universale ka nderin të emërojë «Ambasadoren e Paqes» FATIME KALIMASHI në 3 Tetor 2020 pas pjesëmarrjes në një ditë seminar Zoom të organizuar nga CHantal Chételat Komagata SG. FPU Zvicër.

Faleminderit organizatorëve, Ambasadorëve të Paqes univesale dhe gjithë ata që që më nderuan me titull univesale dhe gjithë ata që që më nderuan me titull univesale! Rrespekt dhe mirenjohese!
Fatime Kalimashi. / KultPlus



Pesë histori për njerëzit më të pashpjegueshëm në histori



Ka shumë njerëz enigmatikë në histori, jeta e të cilëve është e rrethuar me mister; njerëz për të cilët ndoshta nuk do ta njohim kurrë të vërtetën e tyre. Më poshtë janë pesë raste më të famshme.

Legjenda e fëmijëve të gjelbër nga Ulpi: Në shekullin e XII-të, në fshatin Ulp (Woolp) në Suffolk, u shfaq një vëlla dhe motër që kishin lëkurë të gjelbër dhe flisnin një gjuhë krejt të panjohur. Askush nuk e dinte nga vinin dhe ata nuk pranuan të hanë asgjë përveç guaskave. Djali mbeti i dëshpëruar dhe shpejt ndërroi jetë. Vajza mbeti mirë me shëndet dhe përfundimisht filloi të hante ushqime të tjera dhe të humbte ngjyrën e gjelbër. Kur mësoi anglisht, shpjegoi se vinte vendi i errët që e quante Toka e Shën Martin, ku dielli kurrë nuk lindte. Ajo pretendoi se me vëllain e saj po ruanin një tufë delesh, kur filluan të ndiqnin lumin dhe dritën e kur, papritmas, pasi dëgjuan tingullin e një

kambane, u gjendën në Ulp. Deri më sot, askush nuk e di originën e vërtetë të atyre “fëmijëve të gjelbër”.

Njeriu me maskë hekuri: Emri dhe madje pamja e tij nuk u zbuluan kurrë dhe, në histori, ai mbeti i njohur vetëm si “Njeriu me maskë mekur”, ose ndryshe si “Numri 64389000”.

Njeriu me maskën e hekurt ishte një i burgosur në burgun famëkeq të Bastiles në Francë. Të dhënat e tij janë burimi më i rëndësishëm dhe i besueshëm i informacionit në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e Bastiles gjatë mbretërimit të Luixhit (Louis XIV). Karakteri enigmatik, identiteti i të cilit ishte fshehur nën një maskë hekuri, u bë një legjendë si dhe subjekt i

shumë miteve dhe spekulimeve (më e popullarizuara e të cilave është se ai ishte në të vërtetë vëllai binjak i Luixhit). Cilado qoftë e vërteta e vërtetë, shumica e historianëve pajtohen se ai ishte një figurë shumë e rëndësishme. I burgosuri fatkeq vdiq më 19 nëntor 1703 dhe u varros me emrin Marchioly.


Kaspar Hauser: Më 26 maj 1828, një djalë me origjinë të panjohur u shfaq në rrugët e Nurembergut të Gjermanisë, duke mbajtur vetëm një letër drejtuar Kapiten von Wessenigut (i cili ishte në krye të kalorësisë). Autori anonim i letrës shkruante se djali u rrit në një qelë të vogël dhe se nuk kishte parë kurrë një qenie tjetër njerëzore (dhe se kishte mësuar të lexonte dhe të shkruante, si dhe besimin e krishterë, megjithëse nuk u largua kurrë nga shtëpia). Në letër thuhet gjithashtu se dëshira e djalit është të jetë një kalorës. Pasi filluan të qarkullonin thashethemet se Kaspari ishte në të vërtetë Princi i Badenit, i cili mendohej se kishte

vdekur, djali u vra në mënyrë misterioze (pësoi një plagë me thikë). Origjina e tij e vërtetë mbetet një sekret edhe sot e kësaj dite.

Imzot Chouchani: Është ky pseudonimi i një mësuesi anonim dhe misterioz hebre që mësoi një numër të madh nxënësish shumë të vlerësuar. Dihet shumë pak për të, përfshirë edhe emrin e tij të vërtetë. Fillimet e tij, si dhe e gjithë jeta e tij ishin një sekret i ruajtur fort. Edhe në memorialin i tij lexohet: “Rabini i mençur Chouchani. Lindja dhe jeta e tij janë vulosur në një enigmë.” Nuk ka ndonjë shkrim të njohur që ai la pas, por la një trashëgimi shumë të fortë intelektuale përmes nxënësve të tij. Prej tyre dihet që Chouchani kishte një njohuri të gjera rreth shkencës (në përgjithësi); matematikës, filozofisë dhe veçanërisht Talmudit.

Berenger Sauniere: Ishte një prift katolik në fshatin francez Renele-Shato, deri më 1909, kur dha dorëheqjen. Nga 1909 deri në

vdekjen e tij më 1917, ishte prift i papaguar (një prift i pavarur pa famulli, i cili nuk merrte asnjë rrogë nga kisha). Pa ndonjë para, në një farë mënyre arriti të menaxhonte dhe të restauronte kishën e tij të vjetër dhe papritmas ndërtoi një vilë të madhe luksoze dhe të shpenzonte një pasuri të madhe... Shumë pretendojnë se ai gjeti dokumente historikisht të rëndësishme që i sollën pasuri brenda natës dhe u bë është gjithashtu subjekt i legjendave dhe miteve të shumta, shumë prej të cilave përfunduan në bestsellerin e Dan Brownit “Kodi Da Vinçi”. Sauniere madje është e lidhur me historinë e Gralit të Shenjtë, pasi disa teoricienë besojnë se ishte ai që e gjeti atë. Nga ana tjetër thuhet se Sauniere ishte mashtrues i zakonshëm që abuzoi me statusin e tij si prift, nga njerëzit që i dërgonin para me postë, për të shërbyer meshën për ta. Një gjë është e sigurt: jeta e tij është e rrethuar nga misteri dhe mite të shumta dhe legjenda. /Te Sheshi/



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova në Dubrovnik fitoi katër medalje

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka komentuar performancat e xhudistëve të Kosovës që kanë marrë pjesë në garat e Kupës Evropiane në Dubrovnik të Kroacisë, ku kanë fituar katër medalje. Kuka ka thënë se paraqitja e djeshme e garuesve lë shumë për të dëshiruar. "Laura, Flaka e Erza si potencial për medalje serioze për të rritura patën mangësi, sidomos sulmet për hedhje! Performanca e tyre fizike ishte e mirë, por teknikisht nuk ishin as për së afërmi nga ajo që duhet të

jenë. Medaljet janë gjithmonë sukses, por konkurrenca nuk ishte aq e fortë siç është në gara të niveleve ku fitohen pikët olimpikë, as për së afërmi bile. Nakamura, i cili normalisht duhet të garojë në 66 kg, ka marrë medaljen e artë dhe tregoi që ka mundësi dhe potencial, por i duhet shumë punë e madhe. Përgatitja fizike ishte jo e duhura. E diela zakonisht më shërben për analiza dhe nga kjo pjesë ndava me ju vlerësimin tim për garën e mbajtur dje në Dubrovnik", ka thënë Kuka.



Ademi beson në suksesin e Kosovës: Me këmbë në tokë, besojmë se do ta kalojmë edhe këtë pengesë

PRISHTINË, 4 TETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e pret me optimizëm ndeshjen kundër Maqedonisë së Veriut, e cila me të drejtë e ka marrë epitetin historike, pasi ekipi që triumfon të enjten e 8 tetorit në Shkup do ta marrë biletën për finalen e madhe të "play-off"-it për kualifikim në Evropian.

Numri një i futbollit të Kosovës në një intervistë për "Radio Kosovën" ka folur për rëndësinë që ka përkrahja e të gjithëve për dardanët para kësaj ndeshje, e cila, për shkak të pandemisë Covid-19, do të luhet pa tifozë. "Është e rëndësishme t'i përkrahim këta djem para kësaj ndeshje historike, duke pasur parasysh edhe gjendjen me pandeminë dhe shumë peripeci që ka krijuar kjo rrethanë e re në gjithë botën. Besoj se përkrahja dhe pozitiviteti nga të gjithë ne do të jetë krahë i fortë për



futbollistët tanë. Mua më gëzon fakti se interesimi për futbollin dhe ekipin kombëtar është gjithandej në nivelin më të lartë, ashtu si dëshira e secilit për sukses. Këtë gjë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë dhe sigurisht se ky sukses do të përpjesëtohet me shpirtin e çdo shqiptari që i rrah zemra për Kombëtaren e Kosovës", theksoi Ademi.

Kreu i FFK-së shprehu keqardhje

që në këtë ndeshje do të ketë numër shumë të vogël të njerëzve që do ta kenë privilegjin për ta përcjellë atë nga afër. Në fakt, për mediat nga Kosova janë rezervuar vetëm 10 vende, derisa po aq vende janë të rezervuara edhe për stafin e FFK-së. Ai ka thënë se rëndësia e kësaj ndeshje është e jashtëzakonisht e madhe dhe mendja e të gjithëve ka qenë pikërisht në këtë përballje edhe gjatë kualifikimeve të rregullta

për Euro 2020. "Të gjithë e kemi pasur mendjen te kjo ndeshje dhe që ta presim atë sa më të përgatitur sepse jo gjithëherë fiton më i miri. Në këso lloj ndeshje me eliminim direkt mund të ndodhë gjithçka dhe në futboll s'ka asgjë të sigurt, e për këtë ne jemi shumë realë, por duke pasur parasysh kualitetin si ekip dhe rëndësinë e kësaj ndeshje, që nuk do të thotë se nuk është e rëndësishme edhe për Maqedoninë e Veriut, sipas të gjitha analizave, ekspertët e futbollit na shohin favoritë, edhe pse kjo nuk do të thotë asgjë sepse gjithçka vendoset në fushën e gjelbër. Unë besoj se djemtë do ta japin maksimumin, edhe pse, fatkeqësisht, në këtë ndeshje shkojmë me disa mungesa", ka thënë kreu i FFK-së.

Ai shprehu keqardhje që disa futbollistë nuk janë përfshirë këtë herë në listën e Challandes,

por theksoi se kjo është përzgjedhja e trajnerit dhe si drejtues të federatës konsultohen, por nuk i përzihen asnjëherë atij për mënyrën se si e zgjedh formacionin.

Ademi ka thënë se jo rastësisht janë të vlerësuar në Top20 për organizim të ndeshjeve, teksa ka lavdëruar edhe tifozët dardanët që në vazhdimësi kanë treguar kulturë të lartë dhe anim korrekt në çdo ndeshje, duke mos bërë asnjë gabim që do të konvertohej në dënim nga UEFA për federatën. "Duke i pasur parasysh të gjitha këto, ne tashmë e kemi krijuar një imazh dhe një emër që vlerësohet jashtëzakonisht shumë edhe nga UEFA e FIFA, por edhe nga federatat e shteteve të tjera. Sot nuk e ka të lehtë asnjë ekip të luajë me Kosovën dhe të marrë rezultat pozitiv, madje as ekipet që kanë renome botërore", ka theksuar presidenti i FFK-së.

Kosova bëhet pjesë e 160 vendeve të botës për shënimin e Ditës Botërore të Ecjes

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Të dielën në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë është shënuar Dita Botërore e Ecjes nën organizimin e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani, ministrija për Kulturë, Rini e Sport, Vlora Dumoshi dhe

drejtori për Sport në Komunën e Prishtinës, Fitim Rexha, kanë bërë hapjen e aktivitetit për nder të 4 Tetorit - Ditës Botërore të Ecjes.

Ministria Dumoshi ka thënë se ecjen e saj nga shtëpia deri te sheshi "Skënderbeu" ua dedikon personave me aftësi të kufizuara. "Me kënaqësi mora pjesë në

kampanjën e KOK-ut për promovimin e ecjes, kampanjë e organizuar nga TAFISA në 160 vende të ndryshme të botës", ka thënë ministria Dumoshi.

Ky aktivitet ka pasur për qëllim inkurajimin e njerëzve që të zgjedhin mënyra aktive të lëvizjes ose t'i kombinonjë ecjen, vrapimin dhe çiklizmin.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Jeton Ademi shpall të pavlefshëm diplomën e shkollës së mesme, Gjimnazi "Eqrem Çabej" Prishtinë.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

